



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevi, Nr.8, 10000 Prishtinë
info@pak-ks.org – www.pak-ks.org

E hënë, 11 Tetor 2010

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Njësia nr. 13 Urata Shitorja nr. 20 Prishtinë tërhiqet nga likuidimi me shitje të aseteve nr. 4

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) njofton se ka tërhequr nga likuidimi me shitje të aseteve nr. 4. Njësinë 13: Urata Shitorja nr. 20 Prishtinë, që gjendet në lagjen Dardania në Prishtinë me sipërfaqe prej përafërsisht 110 m². Kjo njësi ishte paraparë të privatizohen përmes procesit të likuidimit me shitje të aseteve numër 4 me datën 13 Tetor 2010, bashkë me 20 Njësi/Asete të tjera. Lista e tenderëve për privatizim për shitjen e aseteve numër 4, përmban 20 Njësi.

Më poshtë mund të gjeni listën e plotë të njësive/aseteve që do të privatizohen përmes likuidimit:

Njësia 1: Shitorja A “28 Nëntori” lagja Kamnik Gjilan - Kjo ofertë ofron një mundësi të shkëlqyer për blerjen e dyqanit të NSH “28 Nëntori” që gjendet në katin përdhese të një ndërtese shumëkatëshe në Gjilan, në lagjen Kamnik, me sipërfaqe të përafërt prej rreth 190 m².

Njësia 2: Shitorja B “28 Nëntori” lagja Kamnik Gjilan- Kjo ofertë ofron një mundësi të shkëlqyer për blerjen e dyqanit të NSH “28 Nëntori” që gjendet në katin përdhese të një ndërtese shumëkatëshe në Gjilan, në lagjen Kamnik, me sipërfaqe të përafërt prej rreth 161 m².

Njësia 3: Vushtex Tokë – Prona gjendet në qendër të qytetit të Vushtrrisë. Tokë – përafërsisht 865 m² (parcela numër 120).

Njësia 4: NSH Derma Commerce – Shitore me ndërtim të përkohshëm
Kjo shitje u ofron mundësi investitorëve potencial që të blejnë shitore me ndërtim të përkohshëm, me sipërfaqe rreth 25 m², me lokacion në zone tregtare në qytetin e Therandës, Komuna e Therandës, në afërsi të rrugës kryesore Therandë -Prizren.

Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni Znj. Arta Gosalci në
038 500 400 lokali 1110 apo në arta.gosalci@pak-ks.org

Njësia 5: Depoja e Vogël (Afër Gjykatës për Kundërvajtje) - Aseti (Depoja) ndodhet qendër të qytetit të Pejës në rrugën me të frekuentuar 129/2 (ish-“ Vllaznim Bashkimi”) e njohur si Carshia e Gjatë. Depoja, është ndërtesë njëkatëshe nga betoni dhe tullat dhe ndodhet prapa Shitores Hekurishtja, ka sipërfaqe totale prej rreth 17.5 m². Depoja, është ndërtuar pas konfliktit të vitit 1999.

Njësia 6: Mini Shtëpia e Mallrave - Aseti (Shitorja) gjendet në pjesën kryesore të qytetit të Pejës, Rr. Sheshi i Heronjve afër të ashtuquajturës Pivnica. Shitorja është po ashtu e njohur si Mini Shtëpi e Mallrave, ndodhet në katin përdhese të ndërtesës banuese dhe ka sipërfaqe totale prej rreth 188 m².

Njësia 7: Depoja II (Afër shitores Hekurishtja) - Aseti (Depoja) ndodhet në qendër të qytetit të Pejës në rrugën me të frekuentuar 129/2 (ish-“ Vllaznim Bashkimi”) e njohur si Carshia e Gjatë. Depoja, ka sipërfaqe prej rreth 36 m² është ndërtuar pas konfliktit të vitit 1999.

Njësia 8: Tokë Bujqësore në Vitomericë I - Kjo ofertë përbën një mundësi të mirë për blerjen e tokës bujqësore me sipërfaqe rreth 01.95.60 ha që ndodhet në ngastrë nr. 1371/2, Fleta poseduese nr. 359, Zona Kadastrale Vitomericë, në Pejë.

Njësia 9: Tokë Bujqësore në Vitomericë II - Kjo ofertë përbën një mundësi të mirë për blerjen e tokës bujqësore me sipërfaqe rreth 05.17.00 ha që ndodhet në në ngastrat nr. 1372 dhe 2318, fleta poseduese nr. 398, Zona Kadastrale Vitomericë, afër fshatit Nabërgjan në Pejë.

Njësia 10: Fabrika e Ushqimit të Kafshëve-Toka në Uglar - ofron mundësinë investitorit të mundshëm që të ketë tokë bujqësore me sipërfaqe prej përafërsisht 10,000 m² (1 ha) në Zonën Kadastrale Uglar, Komuna e Fushë Kosovës.

Njësia 11: Magjistrala Carralevë - ofron mundësinë investitorit të mundshëm që të ketë gurëthyesin me sipërfaqe të tokës prej përafërsisht 16716 m² në fshatin Carralevë, Komuna e Shtimes. Kjo njësi posedon të gjitha paisjet për prodhimin e asfaltit.

Njësia 12: Magjistrala Makineria për përpunimin e asfaltit Lipjan - i ofron mundësinë investitorit të mundshëm që të ketë në posedim komplet makinerinë për prodhimin e asfaltit e cila makineri gjendet në Lipjan. Magjistrala Lipjan ofron vetëm asete të lëvizshme.

- Makina për përpunimin e asfaltit,
- Furra e nxemjes,
- Sillosat e rërës
- Sillosat e asfaltit, etj.

Njësia 14: Urata Supermarketi nr. 24 Prishtinë i ofron mundësinë investitorit të mundshëm që të ketë supermarketin me tokë i cili gjendet në rrugën e njohur më parë si Dalmatinska në Prishtinë me sipërfaqe prej përafërsisht 265 m.

Njësia 15: Fabrika e Letrës Toka Lipjan i ofron mundësinë investitorit të mundshëm që të ketë vetëm sipërfaqen e tokës prej përafërsisht 2410 m² në Zonën Kadastrale Lipjan. Vetëm toka është pjesë e këtij tenderi.

Njësia 16: “Banesa”, Shitore dhe bodrum në Ortakoll IV, L/2C, Prizren – përfshinë një (1) shitore me sipërfaqe prej 34.05 m² dhe një (1) bodrum me sipërfaqe prej 68 m², që gjenden në ndërtesën afarist/banesor, Rr. “11 Marsi” / Ortakoll IV, Lam 2C, Prizren.

Njësia 17: “18 Nentori” Njësia në Hoqë të Madhe - ofron për shitje ndërtesën kryesore (fabrika) dhe ndërtesën e administratës me një sipërfaqe të përgjithshme përafërsisht prej 1ha 26ari 05m² në fshatin Hoqa e Madhe, Komuna e Rahovecit.

Njësia 18: “Komuna” Shitorja nr.2 në Prishtinë - ofron për shitje një shitore me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 190.60 m², e cila gjendet në adresë: “Sheshi Zahir Pajaziti” (ish “Sheshi i Republikës” nr.2 - prapa Hotelit Grand), Prishtinë.

Njësia 19: “Komuna ” Shitorja nr. 3 në Prizren - ofron për shitje një shitore me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 42, 72 m², e cila gjendet në adresë: rr. “Jeronim De Rada” p.n. (“Qendra Zejtare SHTRUMFAT”), Prizren.

Njësia 20: “Komuna” Shitorja në Kamenicë - ofron për shitje një shitore me sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 41 m², e cila gjendet në adresë: rr. “Skënderbeu” p.n. (“Qendra zejtare/tregu”), Kamenicë.

Njësia 21: “Theranda” Motel Nasheci - ofron për shitje tokën dhe ndërtesën me sipërfaqe totale prej 27ari dhe 47 m², e cila ndodhet në fshatin Nashec, Prizren.